



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 22-43/2019 regjistri (JR)
Datë 10.12.2024

Nr. 52 i vendimit
Datë 11.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në datën 11.03.2026, në orën 13:05, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen që i përket:

KËRKUES: Shkëlzen Cena, i datëlindjes 05.12.1973, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë; Adresa: Njësia Administrative "****" ****, Rr: "****", Rezidenca "****", Godina Nr. ****, H. ****, AP. ****; Tel: ****; e-mail: ****.

OBJEKTI:

1. Rishikimin e vendimit nr. 36, datë 16.12.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
2. Prishjen e vendimit nr. 12/2019¹ (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe gjykimin në themel të çështjes që lidhet me ankimin kundër vendimit nr. 160, datë 14.06.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
3. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 36 (JR), datë 16.12.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, deri në përfundimin e gjyqimit në themel të çështjes.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 49, 179/b, të Kushtetutës; neni C, pikat 3, 4 dhe 5, neni F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Neni 6/1 i

¹ Kërkimi për prishjen e vendimit nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe gjykimin në themel të çështjes që lidhet me ankimin kundër vendimit nr. 160 datë 14.06.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është një lapsus i kërkuarit pasi vendimi i cituar i përket ish subjektit të rivlerësimit R. G.

Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; Nenet 1, 4/6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012; Nenet 494 shkronja “c” - 501 të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, analizoi pretendimet e z. Shkëlzen Cena në kërkesën për rishikim dhe parashtrimet e paraqitura prej tij me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit nr. 36, datë 16.12.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes, Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Z. Shkëlzen Cena (në vijim “kërkuesi”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 160, datë 14.06.2019, ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër*”.
2. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi dhe është gjykuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, (në vijim “Kolegji”), i cili, pas shqyrtimit të ankimit të paraqitur prej tij, me vendimin nr. 36, datë 16.12.2020, ka vendosur: “*Lënie në fuqi të vendimit nr. 160, datë 14.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena*”.
3. Trupi gjykues i Kolegjit, (në vijim trupi gjykues), në vendimin nr.36, datë 16.12.2020, ka çmuar se në këtë proces të rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit (Shkëlzen Cena): “[...] *Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 55,25 m², ndodhur Kukës, rezultoi me mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e kryera deri në vitin 1999, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me analizën financiare të viteve 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e kryera në këto vite, në kuptim të neneve 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Si rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 160, datë 14.06.2019, duhet lënë në fuqi, pasi gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj*”. Ndërsa, lidhur me kriterin e aftësieve profesionale, etikës si dhe vlerësimitin tërësor të procedurave, Kolegji ka arritur në përfundimin se: “*Në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave që përmbajnë këto praktika të procedimeve penale, si dhe mosdeklarimi i aktmarrëveshjes për premtim shitjeje të apartamentit 1+1, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë në zbatim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit*”. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit, e ka gjetur të bazuar

konkluzionin e Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe ka vlerësuar se vendimi i Komisionit nr. 160, datë 14.06.2019, duhet të lihet në fuqi.

4. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur në Kolegj kërkesën me {***} prot., datë 10.12.2024, e regjistruar në Kolegj si çështja me nr. 22-43/2019, me objekt rishikimin e vendimit të Kolegjit, të përshkruar më sipër. Në këtë kërkesë, kërkuesi ka evidentuar vendimet e gjykatave të juridiksionit të posaçëm penal, të Shkallës së Parë dhe të Apelit, në ngarkim të ish-gjyqtarit A. H., në bazë të së cilave Kolegji ka vendosur pezullimin e tij nga detyra. Sipas kërkuetit, kërkesa për rishikim plotëson në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 494 të të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr. Civile”), dhe dispozitat vijuese të këtij Kodi. Në datën 03.03.2026, kërkuesi ka depozituar në kolegj, parashtrime² lidhur me shkaqet e kërkesës për rishikim të vendimit, përmbajtja e së cilave, rezultoi se kërkuesi ka parashtruar të njëjtat pretendime të ngritura prej tij edhe në kërkesën për rishikim.

II. Pretendimet e kërkuetit

5. Kërkuesi ka paraqitur në Kolegj kërkesën me objekt rishikimin e vendimit të Kolegjit, me pretendimin se trupi gjykues i Kolegjit, që shqyrtoi çështjen e tij, nuk përbënte gjykatë të krijuar me ligj, në kuptim të nenit 6/1 të KEDNj-së, pasi gjyqtari A. H., anëtar i këtij trupi gjykues, është dënuar me vendim të formës së prerë³, për veprat penale "Fshehje e të ardhurave" e parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, si dhe “Refuzimi për deklaramin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaramin”, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal. Sipas kërkuetit, plotësohen kushtet e përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 494 të K. Pr. Civile, për rishikimin e vendimit të dhënë nga Kolegji ndaj tij.

5.1. Në mbështetje të kërimit të tij, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), ka njohur mundësinë për rishikimin e vendimeve, duke cituar vendimin nr. 37474/20 në çështjen “Besnik Cani kundër Shqipërisë”, ku GjEDNj ka konkluduar në mënyrë unanime për shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me të drejtën e kërkuetit për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Po ashtu, kërkuesi ka referuar për analogji edhe qëndrimin e mbajtur nga GjEDNJ, në lidhje me çështjen që i përket ish- gjyqtarit L. D., duke potencuar se prezenca e një anëtari të trupës gjykuese të dënuar me vendim penal të formës së prerë, përbën shkak për cenim të procesit të rregullt ligjor, pavarësisht se konstatimi i faktit penal është bërë pas gjykimit të çështjes ku ish- gjyqtari kishte qenë anëtar i trupit gjykues.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të

² Administruar nga Kolegji me nr. {***} prot., datë 03.03.2026.

³ Me vendimin nr. {***}, datë 18.11.2024, të Gjykatës së Apelit për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin.

anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

7. Në vijim të sa përmblihet më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, së pari, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, dhe së dyti, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
8. Për shkak të kësaj baze ligjore dhe jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues lidhur me kërkimin në rastin konkret, nënvizon qëndrimin se, Kolegji mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e K.Pr.Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
9. Trupi gjykues, pasi analizoi përmbajtjen e kërkesës për rishikim, konstatoi se ajo formalisht bazohej në nenin 494, shkronja “c” e K.Pr.Civile, referim i cili përcaktoi edhe analizën e trupit gjykues që i atribuohet këtij shkak rishikimi, e cila do të trajtohet në vijim të këtij arsytimi.
10. Në vijim të arsytimit mbi juridiksionin e Kolegjit, trupi gjykues sjell në vëmendje vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y., në të cilin është arritur në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Më tej në këtë vendim është arsytuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplisit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuesit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016, nëse nëpërmjet tyre mund të ushtrohej ky juridiksion rishikues i pretenduar nga kërkuesi.
11. Në vijim të sa më sipër, në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nuk parashikohet në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në zbatim të nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilit dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Në vendimin e cituar në paragrafin më sipër, është marrë në analizë, nëse ndërtimi i këtij mekanizmi kontrolli të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë vjen në përputhje me qëllimin e legjislatorit edhe në rastin konkret,

lidhur me tagrat e atribuuar organeve të rivlerësimit dhe posaçërisht Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit në vendimin e referuar më sipër, por edhe në vendimet e marra më pas që kanë shqyrtuar kërkesa të ngjashme për rishikimin e vendimeve të Kolegjit, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

12. Në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, germa “b” e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëjnë pjesë në aktet normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u renditur në hierarkinë e ligjeve pas Kushtetutës së vendit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut së bashku me mekanizmat e saj zbatues, garanton zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenet 17 e 42 të Kushtetutës. Parashikimi i nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korrigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit, është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që edhe Shqipëria është palë.
13. Në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në germën “ë”, parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive. Kushtetuta në nenin 122 përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNj-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjithë niveleve, po ashtu, edhe gjykatat me juridiksion specifik siç është Kolegji. Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar vëzhgohet dhe monitorohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Roli dhe kompetencat e këtij organizmi jovendimmarrës janë garanci e shtuar për mbrojtjen e interesave të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe kryerjen e tij në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 germat e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të

konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

14. Në përfundim, sipas analizës harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjisllacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
15. Për sa më sipër, sa i takon kërkesës së z. Cena, e cila mbështetet në faktin e dënimit të gjyqtarit A. H. me vendim penal përfundimtar, si një shkak rishikimi, bazuar në nenin 494, shkronja “c” e K. Pr. Civile, trupi gjykues vëren se fakti që në rastin konkret vepra penale që pretendohet se është kryer nga z. A. H. para se ai të zgjidhej në funksionin e gjyqtarit të Kolegjit dhe nuk lidhet me procesin e zgjedhjes së tij në këtë detyrë, shkaput çdo lidhje logjike dhe shkakësore midis dhënies së vendimit për të cilin kërkohet rishikimi dhe veprës penale. Për rrjedhojë, nuk vlerësohet se gjen zbatim neni 494, germa “c” e K. Pr. Civile, si elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit edhe në çështje të tjera.
16. Trupi gjykues, pa përsëritur sa është arsytuar gjerësisht nga Kolegji në trajtimin e kërkesave me të njëjtën natyrë e objekt, si dhe duke ndjekur të njëjtën analizë sistematike të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, dhe sipas orientimeve të instrumenteve ndërkombëtare, që normojnë parimet mbi të cilat zhvillohet edhe procesi i rivlerësimit kalimtar, rikonfirmon vlerësimin që në kushtet që nuk ka një vendim nëpërmjet të cilit GjEDNj-ja të ketë konkluduar për shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit të kërkuesit, kërkesa e tij për rishikim nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuesi bën në nenin 494, germa “c” të K. Pr. Civile.
17. Së fundmi, ndonëse shkak i rishikimit i paraqitur prej kërkuesit, nuk i nënshtrohet juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsytimit të mësipërm, sërish ai, sipas një analize *obiter dictum*, konstatohet se edhe nëse do t’i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor, do të konsiderohej i pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi mungon lidhja shkakësore mes vendimmarrjes së gjyqtarit A. H. në çështjen e rivlerësimit të kërkuesit dhe veprës penale për të cilën ai është deklaruar fajtor. Parashikimet ligjore që lidhen me rishikimin në asnjë rast nuk u referohen ndodhive, fakteve apo rrethanave, të cilat nuk rrjedhin apo paraprijnë, ose janë shkak për marrjen e vendimit për të cilin kërkohet rishikimi. Nga ky lexim rezulton se, në mënyrë që vepra penale për të cilën anëtari i trupit gjykues është gjetur fajtor të ketë ndikuar në dhënien e vendimit, pala kërkuese duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të atakuar nëpërmjet rishikimit, ose që në momentin kur gjyqtari ka marrë vendimin, vullneti i tij është vesuar për shkak të kësaj vepre penale, duke ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. Të tilla raste do të ishin sjelljet e një gjyqtari në shkelje të parimeve të paanësisë dhe objektivitetit, provuar nga

një vendim penal i formës së prerë. Një analizë e kryer duke aplikuar këto parime, është në linjë edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së, shtjelluar në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë që diktojnë parimet e nenit 6/1 të Konventës, si në çështjen *Brumarescu*, ku është elaboruar që cenimi i një vendimi përfundimtar mund të legjitimohej vetëm për të korrigjuar një “dështim të drejtësisë”. Për rrjedhojë, nuk vlerësohet se do të gjente zbatim neni 494, germa “c” e K.Pr.Civile, edhe nëse kjo kërkesë do t’i nënshtrohej shqyrtimit, si elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit edhe në çështje të tjera.

18. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa për rishikim e paraqitur prej z. Shkëlzen Cena, është e pabazuar në fakte dhe në ligj dhe për pasojë ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Shkëlzen Cena, për rishikimin e vendimit nr. 36, datë 16.12.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 11.03.2026.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 52 (JR), datë 11.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për: *“Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Shkëlzen Cena, për rishikimin e vendimit nr. 36/2020 (JR), datë 16.12.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë sui generis, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, e bën të pabazuar kërkesën për rishikim të paraqitur nga kërkuari.*
2. Në cilësinë e gjyqtare me mendim paralel, ndaj qëndrim ndryshe nga shumica trupit gjykues, e cila arsyeton se: *“[...] Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarës, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”.*
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: *“Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane ‘Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore’ dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.*
4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t'i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesa e rishikimit ndaj vendimit të tij nuk mund të pranohet. Në këto kushte, në vlerësimin tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr.52 datë 11.03.2026, për çështjen nr. 22-43/2019 regjistër (JR) datë 10.12.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuetit Shkëlzen Cena, për rishikimin e vendimit nr. 36 (JR), datë 16.12.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuetit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislacionit në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkueti A. Y.⁴
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z. Shkëlzen Cena, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafët 5 dhe 6 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁴ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-A.-Y._perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf